


Pregmama

30 kapsula



Acid Folik me 11 Vitamina + 8 minerale

Pregmama përmbanë vitaminat dhe mineralet e nevojshme për një shtatzëni të shëndetshme

**Shtatzëni e lumtur
dhe e sigurtë me Pregmama**

Përfaqësues Ekskluziv për Kosovë:



Kalabria e re, Rr. "Rexhep Krasniqi" pn,
Blloku C2, Objekti B, nr. 1,
10000 Prishtinë - Kosovë
Tel&Fax: +381(0)38 713 776
Mob. +377 (0)45 601 503, +377 (0)45 601 508
E-mail: pharmaplusll@gmail.com

INDIKACIONET

Kombinime të shtesave ushqimore e bazuar në Vitamina dhe Minerale të dobishme për sigurimin e nutrientëve shtesë në dietën ditore.

Hekuri, Vitamina B12 dhe Vitamina B6 kontribuojnë në eritropoezën normale, si dhe reduktojnë lodhjen dhe dobësinë trupore.

Acidi folik është i dobishëm për zhvillimin normal të fetusit. Vitamina C dhe Zinku kontribuojnë në funksionimin normal të sistemit imunitar.

PËRBËRJA

Oksidi i Magnezit	Vitamina E	Vitamina B5	Vitamina B2
Citrati i Kaliumit	Glukonati i Manganit	Vitamina B12	Vitamina B1
Fumarati i Hekurit	Vitamina B3	Vitamina D	Acidi Folik
Vitamina C	Oksidi i Zinkut	Vitamina B6	Joduri i Kaliumit
Tharmi i Seleniumit	Glukonati i Bakrit	Vitamina K1	Vitamina H (Biotina)

KARAKTERISTIKAT

Magnezit: luan rol thelbësor në prodhimin e ATP-së dhe rrjedhimisht të energjisë. Një pjesë e kësaj energjie përdoret nga sistemi nervor dhe atë kryesisht nga truri. Magnezit ka rol thelbësor në funksionimin e sistemit nervor. Poashtu merr pjesë në rregullimin e kontraksionit muskular. Nevoja ditore për të rritet gjatë shtatzënisë dhe gjidhënisë. Doza adekuate e magnezit ndihmon në parandalimin e fillimit të ngërceve, të cilat janë shumë të zakonshme gjatë shtatzënisë.

Kaliumi: kaliumi kontribuon në mbajtjen e ekuilibrit të lëngjeve dhe elektroliteve dhe luan një rol sinjifikant në përcjelljen e impulseve nervore, kontraksionit të muskujve dhe lirimit të energjisë. Në shtatzëni mungesa e kaliumit mund të shkaktojë lodhje, ngërce muskujsh, aritmi jonormale të zemrës, kapsllëk dhe dobësi. Marrja e kaliumit si shtesë kontribuon në zvogëlimin e këtyre simptomave.

Hekuri: Hekuri është komponentë esenciale e hemoglobinës dhe mioglobinës. Luan rol fundamental në bartjen e oksigjenit drejt qelizave. Dhënia e hekurit si shtesë është e dobishme gjatë periudhës fertile, shtatzënisë, gjidhënisë dhe në të gjitha rastet e deficiencës së këtij nutrienti.

Vitamina C dhe E: e neutralizojnë oksigjenin reaktiv dhe llojet e azotit si dhe rrisin nivelin e glutacionit në inde. Duke iu falenderuar këtyre vetive, ato luajnë rol thelbësor në mekanizmat mbrojtës të trupit kundër radikaleve të lira dhe parandalojnë peroksidimin e yndyrnave, sikurse dhe dëmtimin oksidativ të ADN-së dhe proteinave. Zinku, Magnezit dhe Seleniumi: janë minerale me rol thelbësor në formimin e indin lidhor. Ato marrin pjesë në biosintezën e enzimave të rëndësishme siç janë glutation peroksidaza dhe superoksid dismutaza. Bashkë me hekurin, zinku nxitë formimin e hemoglobinës dhe qelizave të kuqe të gjakut.

Kompleksi i vitaminave B: ato ndihmojnë në mbajtjen e funksionit adekuat të sistemit imunitar, kontribuojnë në prodhimin e energjisë dhe manifestojnë veprim efektiv antioksidues. Ato janë të dobishme për të plotësuar nevojat e rritura për këta nutrientë gjatë shtatzënisë dhe gjidhënisë si dhe për funksionimin normal të sistemit nervor.

Bakri: mbështet sistemin imunitar kompetent.

Vitamina D: luan një rol thelbësor në formimin dhe mirëmbajtjen e kockave dhe dhëmbëve. Përdorimi i ekstra sasive të vitaminës D gjatë shtatzënisë ndihmon në absorbimin e kaliumit dhe formimin adekuat të sistemit skeletor të fetusit.

Acidi folik: merr pjesë në sintezën e ADN-së dhe në maturimin e eritrociteve. Gjatë shtatzënisë, dhënia e shtesave të acidit folik është e dobishme për parandalimin e defekteve të tubit neural dhe redukon rrezikun e komplikimeve të tjera gjatë shtatzënisë (ngecje në rritje dhe pre-eklampsia).

Jodi: është elementi kryesor për sintezën e hormoneve tiroide. Nevoja për jod rritet gjatë shtatzënisë. Dhënia e tij si shtesë ndihmon në zhvillimin e trurit të fetusit.

Biotina: kontribuon në krijimin e acideve yndyrore dhe ndihmon metabolizmin e aminoacideve dhe karbohidrateve. Luan një rol të rëndësishëm në formimin dhe përtrirjen e lëkurës, flokëve dhe thonjëve.

PËRDORIMI

Çdo 24 orë të mirret një kapsulë e tillë, para apo pas ushqimit.

KUNDËRINDIKACIONET

Nuk njihen efekte anësore të cilat e shoqërojnë përdorimin e këtij bari. Të evitohet përdorimi i këtij bari në rastet kur kemi alergji ndaj ndonjëres nga komponentat e këtij bari.

RUAJTJA

Të ruhet në vend të thatë dhe të freskët, larg nga burimet direkte të të nxehtit. Të përdoret deri në datën e stampuar në paketim.

PREGMAMA NUK PËRMBAN GLUTEN